



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CML.nr.6/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Muhamet Rexha dhe Nenad Lazic, anëtar, në çështjen juridike të paditësit B.D., nga V., me përfaqësues për pranimin e shkresave S.B., nga ..., Komuna e K., kundër të paditurit F.I., nga V., rr. "K i M"., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Halit Azemi, avokat nga Gj, rr. "B. P"., nr. ..., me objekt kontesti pengim posedim, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të përfaqësuesit të autorizuar për pranimin e shkresave të paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3846/2023 të datës 15.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e palejuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e përfaqësuesit të autorizuar për pranimin e shkresave të paditësit B.D., nga V., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.3846/2023 të datës 15.01.2024.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Vushtrri, C.nr.977/2022 të datës 10.05.2023, në pikën I të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit B.D., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri F. I., e ka penguar paditësin në posedimin e fundit faktit të ngastrës dhe shtëpisë me adresë në V., rr. "A.J"., p.n., njësia P-.....-....., në sipërfaqe prej ..m<sup>2</sup>., ZK V., dhe atë shtëpisë prej 123 m<sup>2</sup> dhe ngastrës ... m<sup>2</sup>., të regjistruara në certifikatën nr. 385/2021, në atë mënyrë që më datë 09.03.2021, pa leje dhe pëlqim të paditësit, arbitrarisht ka hyrë në posedim të paluajtshmërisë dhe ka rrënuar objektin-shtëpinë, dhe të urdhërohet i padituri që të ndalojë me pengimin në këtë ose mënyrë të ngjashme dhe në afat prej 7 ditësh paluajtshmërinë t'ia dorëzoj paditësit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3846/2023 të datës 15.01.2024, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit B.D nga V., ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega V., C.nr.977/2022, i datës 10.05.2023.

Kundër aktvendimit të shkallës së dytë, përfaqësuesi i autorizuar për pranimin e shkresave i paditësit ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si e bazuar dhe të ndryshohet vendimi i plotfuqishëm i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në V., C.nr.977/2022 i datës 10.05.2023, ashtu që të vërtetohet se i padituri ka penguar paditësin në posedimin e tij, duke hyrë në mënyrë arbitrare në posedim të patundshmërisë më datë 09.03.2022.

I padituri nuk ka paditur në përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të përfaqësuesit të autorizuar për pranimin e shkresave të paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 245, ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e palejueshme.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë kishte zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas shqyrtimit dhe administrimit të provave kishte nxjerr aktvendimin C.nr.977/2022 të datës 10.05.2023, me të cilin ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ndërsa Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.3846/2023 të datës 15.01.2024, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të njëjtën e ka refuzuar si të pabazuar, duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, përfaqësuesi i autorizuar për pranimin e shkresave i paditësit, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike - kontestimore fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se në këtë rast kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e palejueshme, për arsye se:

Me nenin 245 paragrafi 1, të LPK-së, përcaktohet se: “Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë prokurori publik mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh.”, me nenin 246 të këtij ligji, përcaktohet se: “Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit nga neni 245 i këtij ligji ngritët nga prokurori publik, në pajtim me ligjin”.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3846/2023 të datës 15.01.2024, është e palejuar, kjo pasi që kërkesën për mbrojtjen e

ligjshmërisë, sipas dispozitës së lartcekur mund ta paraqes vetëm Prokurori i Shtetit për shkeljet e parapara në nenin 247 të LPK-së, ashtu siç parashihet në pikën a) të këtij neni, ku e njëjta mund të paraqitet për: *shkak te shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore; b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.* Ndërsa bazuar në shkresat e lëndës kjo gjykatë vlerëson se kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka paraqitur personi (si përfaqësues i autorizuar për pranimin e shkresave) i paditësit, i cilit sipas ligjit nuk ka autorizim për paraqitjen e saj, e rrjedhimisht kërkesa e paditësit, për mbrojtje të ligjshmërisë është e palejuar.

Në këtë kuptim Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet juridik të jashtëzakonshëm e përfaqësuesit të autorizuar për pranimin e shkresave të paditësit, është e palejuar.

Nga sa u tha më lart dhe në pajtim nenin 221, 245 paragrafi 1 dhe 246 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CML.nr.6/2024, datë 30.04.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari  
Zenel Leku